



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Nr. Ref. 01/1066/ Datë: 05.09.2017

Senati i Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan, në bazë kompetencave të përcaktuara sipas nenit 99 të Statutit të Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 12.6.2017, si dhe vendimit të MASHT-it, nr. 136/01B, të datës 05.07.2017, vendosi të shpall

KONKURS

për pranimin e studentëve të rinj, në vitin e parë të studimeve themelore - baçelor dhe të studimeve master në afatin e dytë për vitin akademik 2017/2018

I. KUSHTET E PËRGJITHSHME

A/ STUDIMET BAÇELOR

1. Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan, në vitin e parë të studimeve, në afatin e dytë (shtator) të konkursit për vitin akademik 2017/2018, do të regjistrojë **1192** studentë të rregullt në studime baçelor dhe **117** studentë të rregullt në studime master.
2. Mbi numrin e përgjithshëm të studentëve të paraparë si më sipër, Universiteti do të regjistrojë deri në **2 %**, përkatësisht deri në **20** studentë të rregullt, që u takojnë familjeve të ngushta të dëshmorëve (anëtarë të familjes së ngushtë të dëshmorëve janë: bashkëshorti, bashkëshortja, fëmijët). Studentët e kësaj kategorie do të shpërndahen në mënyrë proporcionale, sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve, për secilin departament apo program të fakulteteve veç e veç.
3. Nga numri i përgjithshëm, i përcaktuar si në paragrafin 1, bazuar në UA nr. 09/2016 të MASHT-it, Universiteti do të regjistrojë deri në **12 %**, përkatësisht deri **127** studentë të rregullt nga komuniteti jo-shumicë. Kuota prej **12%** të vendeve të rezervuara për regjistrim të studentëve nga komuniteti jo-shumicë do të shpërndahet në mënyrë proporcionale sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve për secilin departament apo program të fakulteteve veç e veç.
4. Në Universitet, në bazë të kuotave të përcaktuara nga MASHT dhe Senati i UKZ-së, mund të pranohen edhe kandidatët nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja. Numri i studentëve të rregullt që do të pranohen si në paragrafin 1 të pikës 1 është deri **239** studentë dhe **18** studentë për studime master. Kandidatët që kanë lindur në vendet e sipërhënuara dhe të cilët shkollimin e mesëm e kanë kryer në po ato vende.
5. Në Universitet, në bazë të kuotave të përcaktuara nga Senati, mund të pranohen edhe kandidatët jashtë Kosovës, përkatësisht **20** studentë të rregullt, për secilin departament apo program të fakulteteve veç e veç.
6. Universiteti do t'i ketë në konsideratë në mënyrë të veçantë edhe kandidatët me nevoja të veçanta, të cilët e kalojnë pragun e provimit pranues.
7. Të drejtë pranimi në Universitetin "Kadri Zeka" kanë të gjithë kandidatët kosovarë, të cilët e kanë përfunduar me sukses shkollën e mesme në Kosovë apo jashtë Kosovës dhe e kanë diplomën për shkollimin e kryer.
8. Kandidatë jo-kosovarë konsiderohen kandidatët të cilët shkollimin e mesëm e kanë mbaruar jashtë Kosovës dhe me rastin e paraqitjes në konkurs, duhet të verifikohet njohja e institucionit shkollor në bazë të listës së MASHT-it e cila iu dorëzohet të gjitha njësisve akademike.
9. Kandidatët të cilët i kanë diplomat e fituara jashtë Kosovës duhet ta bëjnë nostrifikimin e tyre në MASHT.
10. Universiteti do të sigurojë përgatitjen e testeve për provim pranues në gjuhën në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin paraprak dhe për të cilën deklarohen paraprakisht në formularin për vetëdeklarim.
11. Njësitë akademike përkatëse, me rastin e aplikimit të kandidatëve nga komuniteti jo-shumicë, bëjnë verifikimin e dokumentacionit pedagogjik, duke përfshirë dëftesat dhe diplomat në gjuhën në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin e mesëm.
12. Deklarimi i rrejtshëm në formularin për vetëdeklarim, sipas nenit 391 të Kodit Penal (KODI NR. 04/L-082) të Republikës së Kosovës konsiderohet vepër penale.

13. Kandidatët të cilët kanë të regjistruar një program studimi, në kuadër të Universitetit “Kadri Zeka”, nuk kanë të drejtë konkurrimi në program tjetër studimi pa përfunduar studimet në programin ku kanë qenë duke studiuar ose pa u regjistruar nga programi aktual i studimeve.
14. Kandidatët për praninë si studentë në Universitetin “Kadri Zeka”, në vitin akademik 2017/18, nuk mund të konkurrojnë më shumë se në një fakultet, departament, drejtim apo program.

B/ STUDIMET MASTER

1. Universiteti “Kadri Zeka” në Gjilan, në studimet pasdiplomike – MASTER në afatin e dytë, për vitin akademik 2017/2018 do të regjistrojë **117** studentë të rregullt.
2. Në studimet master mund të konkurrojnë kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet baçelor me notë mesatare me së paku 7.50 nga fusha e Shkencave Kompjuterike, Juridike, Ekonomike dhe nga ndonjë fushë e afërt me këto, apo studimet themelore para hyrjes në fuqi të Deklaratës së Bolonjës nga këto fusha të studimit në të gjitha institucionet e akredituara të arsimit të lartë të Kosovës.
3. Në kushte të barabarta, përparësi në praninë do të kenë studentët të cilët kanë mbaruar studimet themelore në Universitetin “Kadri Zeka” në Gjilan.
4. Të drejtë konkurrimi kanë edhe ata të cilët studimet themelore i kanë përfunduar jashtë Kosovës. Në raste të tilla kandidati/ja duhet të sjellë vendimin mbi nostrifikimin e diplomës, e cila lëshohet nga MASHT-i.

II. AFATET E KONKURSIT

II.1. PËR STUDIME BAÇELOR

Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve baçelor, orari do të jenë si në vijim:

1. Paraqitja e dokumenteve zgjatë prej datës **6.9.2017** deri më **13.9.2017** nga ora **9.00** deri në orën **16.00** (dokumentet do të pranohen çdo ditë, me përjashtim të ditës së diel).

II.2. PËR STUDIME MASTER

1. Paraqitja e dokumenteve zgjatë prej datës **18.9.2017** deri më **16.10.2017** nga ora **9.00** deri në orën **16.00** (dokumentet do të pranohen çdo ditë, me përjashtim të ditës së diel).

Me rastin e paraqitjes, kandidatët duhet t'i sjellin këto dokumente:

Për studimet: baçelor

- a) *Ekstraktin e lindjes (origjinal),*
- b) *Dëftesat e të gjitha klasave të shkollës së mesme (origjinal ose të noterizuara),*
- c) *Diplomën e kryerjes së shkollës së mesme ose dëftesën e maturës, nëse ka pasur provim të maturës (origjinal ose të noterizuar), për studime baçelor,*
- d) *Kopjen e letërnjoftimit,*
- e) *Vendimin mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit (vendimi bëhet në MASHT),*
- f) *Fletëparaqitja e plotësuar shkarkohet gjatë aplikimit online nga interneti,*
- g) *Vegza (Linku) për konkurrim online përmes internetit është: <http://uni-gjilan.net>*
- h) *Pagesën prej 2.5 euro. Forma e pagesës shkarkohet dhe shtypet nga uebfaqja e Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan, ndërsa pagesa bëhet në bankë.*

Dokumentet nën pikën b/ dhe c/ mund të pranohen dublikatë vetëm nëse dëshmohet me vërtetim të organeve kompetentepër humbje, dëmtim, vjedhje etj. *P.S. Pas nxjerrjes së dokumenteve dublikatë, dokumentet origjinale nuk mund të shfrytëzohen nga kandidati pasi që ky veprim konsiderohet vepër penale.*

Për studimet: Master

- a) *Ekstraktin e lindjes (origjinal);*
- b) *Diplomën origjinale ose certifikatën e diplomimit të studimeve themelore;*
- c) *Pasqyren e nota të studimeve themelore me notë mesatare;*
- d) *Kopjen e letërnjoftimit;*
- e) *Vendimin mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit. (vendimi bëhet në MASHT);*
- f) *Fletëparaqitja e plotësuar shkarkohet gjatë aplikimit online nga interneti;*
- g) *Vegza (Linku) për konkurrim online përmes internetit është: <http://uni-gjilan.net>*
- h) *Pagesën prej 2.5 euro. Forma e pagesës shkarkohet dhe shtypet nga uebfaqja e Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan, ndërsa pagesa bëhet në bankë.*

Provimi pranues për **Fakultetin Juridik** dhe **Fakultetin e Shkencave Kompjuterike** do të mbahet më **15.9.2017**, kurse për **Fakultetin e Edukimit** dhe **Fakultetin Ekonomik**, më **16.9.2017**.

Provimi pranues për studime **master**, do të mbahet më datë **18.10.2017**.

1. Njoftimet dhe orarin për vendin ku do të mbahen provimet pranuese mund të merren në fakultetet përkatëse, si dhe në ueb faqen e universitetit.
2. *Detajet lidhur me kohën e mbajtjes së provimit pranues sipas njësive akademike do të shpallen në ueb faqen e universitetit më 14.9.2017, kurse për studime master më 17.10.2017.*

3. Të gjithë kandidatët në provim pranues duhet ta posedojnë letërnjoftimin, pa të cilën nuk mund t'i nënshtrohen provimit pranues. Në kohën e mbajtjes së provimit pranues kandidatët nuk mund të kenë pranë vetes telefona celularë dhe asnjë mjet tjetër teknologjik.
4. Shpallja e rezultateve preliminare të provimit pranues për baçelor do të bëhet, më së voni, deri më **18.9.2017**, kurse për master më **19.10.2017** në fakultetet përkatëse, si dhe në uebfaqen e universitetit.
5. Shpallja e rezultateve përfundimtare të provimit pranues për baçelor do të bëhet, më së voni, deri më **22.9.2017**, ndërsa për master **23.10.2017**.
6. Kandidatëve u rekomandohet që para paraqitjes në konkurs të bëjnë kopje të mjaftueshme të dokumenteve, sepse dokumentet origjinale nuk do të mund t'i tërheqin deri në diplomim apo çregjistrim nga fakulteti.
7. Për informata më të hollësishme, kandidatët mund t'u drejtohen fakulteteve përkatëse ose ta vizitojnë faqen e internetit: www.uni-gjilan.net

III. MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE

• PËR STUDIME BACELOR

1. Përzgjedhja e kandidatëve për të gjitha fakultetet do të bëhet sipas kriterëve si në vijim:
 - a)- Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme e nuk kanë pasur provim të maturës: Numri maksimal i pikëve sipas kriterëve vijuese është 100 pikë dhe atë:
 - Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë dhe
 - Suksesi në provim pranues deri në 70 pikë.
 - b)- Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme dhe kanë dhënë me sukses provimin e maturës: Numri maksimal i pikëve sipas kriterëve vijuese është 100 pikë dhe atë:
 - Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë;
 - Suksesi në maturë deri në 30 pikë;
 - Suksesi në provimin pranues deri në 40 pikë.
2. Të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi kanë vetëm kandidatët që arrijnë së paku 40 % nga numri i pikëve të parapara për provim pranues.
3. Kandidatët të cilët nuk arrijnë së paku 40 % nga numri i pikëve të parapara për provim pranues nuk mund të pranohen edhe nëse mbeten vende të paplotësuara sipas konkursit.
4. Kandidatët nga Lugina e Preshevës, nga familjet e dëshmorëve dhe komunitetet joshumicë, mund të rangohen në listën e të pranuarve, nëse kanë arritur së paku 30 % të pikëve nga provimi pranues.
5. Nëse numri i pikëve të disa kandidatë të ranguar si të fundit në listën e të pranuarve është i barabartë me kandidatë e tjerë jashtë numrit të planifikuar për pranim, zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të suksesit të provimit pranues, e nëse edhe pikët e provimit pranues janë të njëjta atëherë do të merret parasysh suksesi i shkollës mesme. Në qoftë se edhe suksesi nga shkolla e mesme është i njëjtë, atëherë përparësi do të kenë kandidatet e gjinisë femërore.
6. Regjistrimi i studentëve të pranuar në vitin e parë, bëhet në administratën e njësive akademike, sipas orarit të përcaktuar me këtë konkurs.

• PËR STUDIME MASTER

Numri maksimal i pikëve sipas kriterëve është 100 pikë, dhe atë:

- Suksesi në studimet themelore deri në 50 pikë;
- Suksesi në provimin pranues deri në 50 pikë;
- Të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi kanë vetëm kandidatët që arrijnë së paku 40 % nga numri i pikëve të parapara për provim pranues;
- Nëse numri i pikëve të disa kandidatë të ranguar si të fundit në listën e të pranuarve është i barabartë me kandidatë tjerë jashtë numrit të planifikuar për pranim, zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të suksesit të provimit pranues, e nëse edhe pikët e provimit pranues janë të njëjta atëherë do të merret parasysh nota mesatare nga studimet themelore. Nëse edhe suksesi nga studimet themelore është i njëjtë atëherë përparësi do të kenë kandidatët e gjinisë femërore;
- Regjistrimi i studentëve të pranuar në vitin e parë bëhet në administratën e njësive akademike, sipas orarit të përcaktuar me këtë konkurs.

7. E DREJTA E ANKESËS DHE AFATI PËR ANKESË

IV.1 Baçelor:

1. Kandidatët të cilët nuk janë pranuar mund t'i paraqesin ankesë fakultetit përkatës më së largu 48 orë pas publikimit të rezultateve. Pas këtij afati, ankesat nuk do të pranohen. Shqyrtimi i ankesave bëhet nga Komisioni për shqyrtimin e ankesave nga fakulteti përkatës më datë 21.9.2017 duke filluar nga ora **10.00**.
2. Kandidatët të cilët nuk janë pranuar, mund t'i tërheqin dokumentet e tyre në fakultetin përkatës nga data **21.9.2017** deri më **25.9.2017**.

IV.2 Master

1. Kandidatët të cilët nuk janë pranuar mund t'i paraqesin ankesë fakultetit përkatës më së largu 48 orë pas publikimit të rezultateve. Pas këtij afati, ankesat nuk do të pranohen. Shqyrtimi i ankesave bëhet nga

8. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE TË PRANUAR

V.1 Bachelor

- Regjistrimi i kandidatëve të pranuar do të bëhet në administratën e njësive akademike sipas këtij orari:

- Të gjitha fakultetet nga data 25.9.2017 deri më 27.9.2017 prej orës 9:00 - 15:00

V.2 Master

- Regjistrimi i kandidatëve të pranuar do të bëhet në administratën e njësive akademike sipas këtij orari:
 - Nga data 25.10.2017 deri më 26.10.2017, prej orës 9:00 - 15:00;
- Jashtë këtij afati kandidatët e pranuar nuk do të mund të regjistrohen, prandaj luteni që t'i përmbaheni afatit të lartshënuar.
- Kandidatët e pranuar për regjistrim duhet të paraqesin:
 - Fletëregjistrimin e plotësuar, i cili merret me rastin e regjistrimit,
 - Dy fotografi (formati 4.5 x 6 cm), të cilat duhet të jenë sipas normave dhe rregullave për dokumente personale.
 - Studentët shtetas të Republikës së Kosovës që fillojnë studimet në Universitetin "Kadri Zeka", vitin e parë të studimeve bachelor e kanë falas.
 - Pagesa për një semestër për studentë që nuk janë shtetas të Republikës së Kosovës, do të jetë në lartësi prej 25 € për studime të rregullta, kurse për studime master 150 €, sipas Udhëzimit Administrativ nr.17/2014 të datës 6.05.2014.
- Pagesa bëhet në njërin prej bankave afariste me fletëparaqitje për pagesë, e cila shkarkohet dhe shtypet nga Ueb faqja e Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan.

I. FAKULTETI I EDUKIMIT

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **308** studentë të rregullt dhe atë në departamentet si në vijim:

Departamenti- Programi	Për studime të rregullta	Për kandidatët nga Lugina e Preshevës	Për kandidatët nga komunitetet jo-shumicë	Për kandidatët nga Mali i Zi, Shqipëria dhe Maqedonia	Për kandidatët anëtarë të familjeve të dëshmorëve	Gjithsej
Gjithsej	200	70	24	10	4	308
FILLOR	120	35	14	5	2	176
PARASHKOLLOR	80	35	10	5	2	132

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët e fushës së ngushtë profesionale të degës përkatëse të fakultetit dhe atë:

- Gjuhë dhe letërsi shqipe, Matematikë dhe Edukatë qytetare.

II. FAKULTETI EKONOMIK

Në vitin e parë të studimeve në afatin e dytë do të regjistrojë **514** studentë të rregullt, dhe atë në departamentet si në vijim:

Departamenti- Programi	Për studime të rregullta	Për kandidatët nga Lugina e Preshevës	Për kandidatët nga komunitetet jo-shumicë	Për kandidatët nga Mali i Zi, Shqipëria dhe Maqedonia	Për kandidatët anëtarë të familjeve të dëshmorëve	Gjithsej
Gjithsej	326	103	60	15	10	514
BANKA, FINANCA DHE KONTABILITET	145	34	24	5	4	212
MENAXHMENT	125	34	24	5	4	192
MARKETING	56	35	12	5	2	110

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët e lëmit të ngushtë profesional të departamentit përkatës të fakultetit dhe atë:

- Fakulteti Ekonomik (të gjitha drejtimet): Hyrje në ekonomi dhe Matematikë.

III. FAKULTETI JURIDIK

Në vitin e parë të studimeve në afatin e dytë do të regjistrojë **194** studentë të rregullt

Departamenti- Programi	Për studime të rregullta	Për kandidatët nga Lugina e Preshevës	Për kandidatët nga komunitetet jo-shumicë	Për kandidatët nga Mali i Zi, Shqipëria dhe Maqedonia	Për kandidatët anëtarë të familjeve të dëshmorëve	Gjithsej
Gjithsej	125	31	29	5	4	194
JURIDIK	125	31	29	5	4	194

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët e fushës së ngushtë profesionale të degës përkatëse të fakultetit dhe atë:

- Fillet e së drejtës, E drejta kushtetuese dhe Edukatë qytetare.

IV. FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **176** studentë të rregullt

FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE	Për studime të rregullta	Për kandidatët nga Lugina e Preshevës	Për kandidatët nga komunitetet jo-shumicë	Për kandidatët nga Mali i Zi, Shqipëria dhe Maqedonia	Për kandidatët anëtarë të familjeve të dëshmorëve	Gjithsej
Departamenti - Programi						
Gjithsej	120	35	14	5	2	176
Shkenca kompjuterike	120	35	14	5	2	176

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët e fushës së ngushtë profesionale të degës përkatëse të fakultetit dhe atë:

- Matematikë dhe Informatikë.

V. PROGRAMI MASTER I PËRBASHKËT: E-QEVERISJA - FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE, FAKULTETI EKONOMIK DHE FAKULTETI JURIDIK

Në vitin e parë të studimeve në afatin e dytë master do të regjistrojë **82** studentë të rregullt

Departamenti- Programi	Për studime të rregullta	Për kandidatët nga Lugina e Preshevës	Për kandidatët nga komunitetet jo-shumicë	Për kandidatët nga Mali i Zi, Shqipëria dhe Maqedonia	Për kandidatët anëtarë të familjeve të dëshmorëve	Gjithsej
Gjithsej	55	9	7	7	4	82
FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE	18	3	3	3	2	29
FAKULTETI EKONOMIK	17	3	2	2	1	25
FAKULTETI JURIDIK	20	3	2	2	1	28

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët e fushës së ngushtë profesionale nga tri fakultetet përkatëse dhe atë:

- Informatika, Ekonomiks, Administratë dhe Gjuhë Angleze.

VI. PROGRAMI MASTER I PËRBASHKËT: QEVERISJA LOKALE DHE SHOQËRIA DEMOKRATIKE - UNIVERSITETI “KADRI ZEKA” GJILAN, UNIVERSITETI “UKSHIN HOTI” PRIZREN DHE UNIVERSITETI “HAXHI ZEKA” PEJË

Në vitin e parë të studimeve Master do të regjistrojë **35** studentë të rregullt

Departamenti- Programi	Për studime të rregullta	Për kandidatët nga Lugina e Preshevës	Për kandidatët nga komunitetet jo-shumicë	Për kandidatët nga Mali i Zi, Shqipëria dhe Maqedonia	Për kandidatët anëtarë të familjeve të dëshmorëve	Gjithsej
Gjithsej	20	9	2	2	2	35
QEVERISJA LOKALE DHE SHOQËRIA DEMOKRATIKE	20	9	2	2	2	35

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët e fushës së ngushtë profesionale të degës përkatëse të fakultetit dhe atë:

- E Drejta Administrative dhe e Drejta Kushtetuese

Qeverisja Lokale dhe Shoqëria Demokratike është program i përbashkët i tri universiteteve: Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan, Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren dhe Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë. Këto tri universitete do të pranojnë nga 20 studentë në këtë program në bazë të kuotave të tjera studentët do të ndahen proporcionalisht sipas marrëveshjes ndërmjet universiteteve.

Studimet në këtë program do të bëhen me sistem rotativ, ku një semestër do të jetë në UKZ dhe pastaj vazhdohet me UPZ dhe semestri i fundit në UHZ.

Tema e diplomës do të jetë e lirë për përzgjedhje nga studentët se në cilin universitet dëshirojnë që ta mbrojnë.